

VENDIM
Nr.840, datë 13.12.2006

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.198, DATË 5.4.2006 TË
KËSHLLIT TË MINISTRAVE “PËR PRANIMET NË UNIVERSITETET DHE SHKOLLAT
E LARTA, PËR VITIN AKADEMIK 2006-2007, NË SISTEMIN ME KOHË TË PLOTË DHE
PËR CAKTIMIN E TARIFËS SË SHKOLLIMIT, NË SISTEMIN ME KOHË TË PLOTË”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 24, 31 e 42 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.198, datë 5.4.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) në pikën 7, në fjalinë e dytë, pas fjalëve “...degë e dytë...” të shtohen “...të jetë e diferencuar për degë të ndryshme dhe...”.

b) Në pikën 10.2, në fund të paragrafit, të shtohen fjalët “...sipas pikës 9, të këtij vendimi.”.

c) Në pikën 13, fjalët “...të barabartë me tarifën e kuotave kryesore, duke filluar nga viti akademik 2006-2007.... ” zëvendësohen me “...të njëjtë me tarifën për degë të dytë, në të gjitha vitet e studimit...”.

2. Efektet financiare të përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha